

20222463626

СОБРАНИЕ НА РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА

L I G J

I HUAMARRJES TË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT ME HUA NGA BANKA BOTËRORE I RINDËRTIMIT DHE E ZHVILLIMIT – BANKA BOTËRORE, SIPAS MARRËVESHJES SË HUASË PËR FINANCIMIN E PROJEKTIT PËR KRIJIMIN E INSTITUCIONEVE EFEKTIVE, TRANSPARENTE DHE LLOGARIDHËNËSE PËR MENAXHIM ME FINANCAT PUBLIKE

Neni 1

Republika e Maqedonisë së Veriut merr hua nga Banka Ndërkombëtare e Rindërtimit dhe e Zhvillimit - Banka Botërore, me vlerë prej 20.000.000 eurove, të destinuara për zbatimin e Projektit për Krijimin e Institucioneve Efektive, Transparente dhe Llogaridhënëse për Menaxhimin e Financave Publike.

Neni 2

Kushtet dhe mënyra e shfrytëzimit të huasë nga neni 1 i këtij ligji përcaktohen me Marrëveshjen e Huasë për Financimin e Projektit për Krijimin e Institucioneve Efektive, Transparente dhe Llogaridhënëse për Menaxhim me Financat Publike, që do të lidhet ndërmjet Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim - Banka Botërore.

Në emër të Republikës së Maqedonisë së Veriut, Marrëveshja e Huasë nga paragrafi 1 i këtij neni nënshkruhet nga ministri i Financave.

Neni 3

Periudha e shlyerjes së huasë së nenit 1 të këtij ligji është 11 vite, duke përfshirë periudhën grejs prej katër vitesh.

Norma e interesit është EURIBOR gjashtëmujor me interval variabil.

Pas nënshkrimit të Marrëveshjes së Huasë të nenit 2, paragrafi (1) të këtij ligji, Republika e Maqedonisë së Veriut do t'i paguajë Bankës Ndërkombëtare e Rindërtimit dhe e Zhvillimit - Banka Botërore, provizion të njëhershëm me vlerë prej 0.25% të vlerës së huasë.

Republika e Maqedonisë së Veriut do t'i paguajë Bankës Ndërkombëtare të Rindërtimit dhe të Zhvillimit - Bankës Botërore, provizion me vlerë prej 0.25% të pjesës së patërhequr të huasë në nivel vjetor.

Huamarrja nga neni 1 i këtij ligji do të shlyhet në 14 këste gjysmëvjeçare, prej të cilave 13 këste gjysmëvjeçare do të jenë me vlerë prej 7.14% të vlerës së huasë, ndërsa kësti i fundit i 14 me vlerë prej 7.18% të vlerës së huasë. Huaja e nenit 1 të këtij ligji do të shlyhet më datat 15 maj dhe 15 nëntor të çdo viti.

Neni 4

Shfrytëzues së mjeteve nga huaja sipas nenit 1 të këtij ligji janë Ministria e Financave, Ministria e Financave – Drejtoria e të Ardhurave Publike dhe Sekretariati i Përgjithshëm i Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut, për nevojat e Kabinetit në fushëveprimin e të cilit janë çështjet në lidhje me realizimin e projektit të nenit 1 të këtij ligji.

Neni 5

Republika e Maqedonisë së Veriut huanë sipas nenit 1 të këtij ligji do ta shlyejë nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Neni 6

Ky ligj hyn në fuqi në ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut.